



KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Emri i Autoritetit Kontraktues: **KOMUNA E RAHOVECIT**, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: **“DRURI S” Sh.p.k. me adresë në Rahovec, të cilën e përfaqëson Sead Gashi**

Janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

TITULLI I KONTRATËS: FURNIZIMI I BIBLIOTEKAVE ME INVENTAR

Numri i Prokurimit: **623-20-7682-1-3-6**

Numri i Brendshëm: **623-20-070-1-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Furnizimi i Bibliotekave me Inventar**, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: **datën e nënshkrimit dhe përfundon për një periudhë prej 2 muaj.**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [5] ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë: **Në Komunën e Rahovecit.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 5,495.26 Euro;

(Pesëmijë e katërqindëntëdhjetepesë Euro e njëzetegjashtë Cent).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumë që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip]² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik		Për Autoritetin Kontraktues:	
Emri:	Sead Gashi	Emri:	Astrit Mullabazi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menaxher i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	04.12.2020	Data:	04.12.2020
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Paramasa dhe Paralogaria per furnizim te bibliotekave me inventar

Verejtje: Kontraktori duhet patjeter t'iu referohet Specifikimeve Gjenerale dhe detaleve. Cmimet duhet te perfshijne furnizimin, transportin dhe installimin/finalizimin e te gjitha materialeve. Kontraktori duhet te dorezoje Deklaratat e Konformitetit per te gjitha materialet e perdorura ne kete projekt. Per te gjitha punet e ekzekutuara, patjetër duhet të bëhen testet paraprake.

1. PUNËT E NGJYROSJES

Poz.1	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Cmimi	Shuma
1.01	Furnizimi transporti dhe lyerja e mureve me polikolor dhe atë në dy shtresa. Në qmim të llogaritet edhe mbyllja dhe trashimi i plasariljeve eventuale. Nuancat e ngjyrës të përcaktohen nga investori.	m ²	120.0	1.00	120.00
					120.00

2. PUNËT E MOBILIMIT, MONTIMI I INVERTARIT

Poz.2	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Cmimi	Shuma
2.01	Furnizimi transporti dhe montimi i rafteve me gjërësi prej 40cm. Montimi i tyre te bëhet në mure nëpërmjet ankerimit ose mbështetjes në pjesë të ankeruara të cilat nuk duhet të ndikojnë në estetikën e rafteve. Materiali i raftëve të jetë mediapani i lyer me ngjyrë të bardhë dhe trashësi 3cm. Në gjatësi të raftit të llogariten edhe pjesët harkore të tij sikurse në skicë.	m	48.0	25.00	1,200.00
2.02	Furnizimi transporti dhe montimi i raftëve dekorative në mure të bibliotekës me dimensione Lxhxb=70x70x30cm. Materiali të jetë nga mediapani, modeli ashtu sikurse në skicë. Ngjyra të përcaktohet nga autoriteti kontraktuese.	copë	2.0	35.00	70.00
2.03	Furnizimi transporti dhe montimi i tavolinës së punës së bibliotekës. Dim të tavolinës janë Lxhxb=336 x 120 x 80cm. Tavolina të punohet me mediapan të mveshur dhe të lyer me ngjyrë të bardhë, tavolina të punohet në dy nivele sikurse në skicën e dhënë.	copë	1.0	725.00	725.00
2.04	Furnizimi transporti i tavolinës dekorative me dim. Lxhxb=160 x 80 x 40cm. Konstruksioni mbajës i tavolinës të punohet prej profileve të hekurit me preje tërthore me 3x3cm, tavolina të punohet në tri nivele, pjesa e paraparë për vendosjen e gjësendeve të punohet prej qelqi 6mm. Në qmim të llogaritet lyerja e profileve me ngjyrë antikorozive dhe ngjyrë të yndyrshme dhe atë në dy shtresa.	copë	1.0	250.00	250.00
2.05	Furnizimi, transporti dhe vendosja e kokërrshl tëve në hapsirën e bibliotekës. Materiali të jetë nga plishi me kualitet të lartë. Modeli dhe nuancat të përcaktohen nga autoriteti kontraktuese.	copë	15.0	28.00	420.00
2.06	Furnizimi, transporti dhe vendosja e tepihave në hapsirën e bibliotekës me diemnsione 1.60x2.00m. Materiali dhe ngjyra të përcaktohet nga autoriteti kontraktues.	copë	8.0	40.00	320.00



2.07	Furnizimi, transporti dhe vendosja e karrigës ergonomike, me rota, me konstrukcion mbajtës prej hekuri, mveshje prej lëkure, si dhe mundësi të përshtatjes së lartësisë dhe mbështetjes. Kamika duhet të vendoset në hapsirën e bibliotekës dhe të jetë me dimensione Lxhxh=65x65x85cm. Materiali dhe ngjyra të përcaktohet nga autoriteti kontraktues.	copë	1.0	80.00	80.00
	Furnizimi, transporti dhe vendosja e karrigave në hapsirën e bibliotekës me dimensione Lxhxh=60x55x80cm. Materiali dhe ngjyra të përcaktohet nga autoriteti kontraktues. Të jenë identike me ato në skicë.	copë	8.0	40.00	320.00
2.08	Furnizimi transporti dhe vendosja e tavolinave për lexim me dimensione Lxhxh=220x80x100cm. Konstrukcioni mbajtës i tavolinës të punohet prej profileve të hekuri me prerje tërthore 5x5cm, pjesa e sipërme e tavolinës të punohet prej mediapani 4cm. Në qimim të llogaritet lyerja e profileve me ngjyrë antikorrozive dhe ngjyrë të yndyrshme dhe atë në dy shtresa. Ngjyra e tavolinës të përcaktohet nga autoriteti kontraktues.	copë	2.0	420.00	840.00
2.09	Furnizimi transporti dhe montimi i perdeve shiritore me gjërësi të shiritit 12.5cm së bashku me mbajtësen dhe mekanizmin profesional. Llogaria bëhet për m ² të perdës, si dhe ngjyra të përcaktohet nga autoriteti kontraktues.	m2	104.0	3.00	312.00
					4,537.00
REKAPITULIM					
1	PUNËT E NGJYROSJËS			€	120.00
2	PUNËT E MOBILIMIT-MONTIMI I INVERTARIT			€	4,537.00
				TOTALI: €	4,657.00
				TVSH 18% €	838.26
				TOTALI ME TVSH: €	5,495.26

